



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**ZL Anr.770/2017**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada - Gillogjani anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Burim Muji kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Gjilan nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Gjilan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**Refuzohet** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Burim Muji kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Gjilan nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Gjilan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

#### **A R S Y E T I M**

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 16:10, ka pranuar një apel nga Burim Muji kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Gjilan nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Gjilan, në të cilin pretendon se në rezultatet preliminare të publikuara nga KQZ ka pasur 310 vota ndërsa me publikimin e rezultateve përfundimtare i janë fshirë 5 vota. Më tej parashtruesi i ankesës ka theksuar se votuesi Fadil Latifi së bashku me djalin e tij në vendvotimin 0408D/01R ka votuar subjektin politik AAK, mirëpo atyre ju mungon një votë, po ashtu ka theksuar se votuesi Emrush Rexhepi ka votuar në VV-në 0408D/02R, subjektin politik AAK, por në rezultat shihet se i mungon vota e tij. Parashtruesi i ankesës tutje ka theksuar se në vendvotimin 0401x/17R ka pasur dëmtim të votës ku ai është dëmtuar për dy vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të ankuesit gjeti se, ankuesi nuk ka ofruar prova bindëse për të dëshmuar pretendimet për parregullsitë e cekura në apel. Prandaj Paneli apelin e ankuesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte bindëse dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara mirë dhe si të tilla apeli i ankuesit u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.770/2017 me datën 12.11.2017.



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.